



Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received/Delivery	22.07.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINACK	4240/2022		1/14



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.313/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas kërkesës së datës 17.06.2022 e ka ri-shqyrtuar ankesën e ankuesit me numër A.nr.313/2022 të datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] e cila ankesë është bashkuar me ankesën me numër A.nr.102/2022 të datës 09.02.2022 dhe ankesën me numër A.Nr.232/2022 të datës 14.03.2022 sipas vendimit Nr.22/2022 të datës 05.05.2022 të Kryetarit të Këshillit, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në çështjen juridike "*masë disiplinore-largim nga Shërbimi Civil*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.313/2022 e datës 30.03.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] e riaktivizuar sipas kërkesës së datës 17.06.2022.
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.03/2022 Komisionit Disiplinori Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 16.03.2022 lidhur me pezullimin e ankuesit dhe procedurës disiplinore ndaj tij.
- III. Ndryshohet masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit sipas Vendimit KD Nr.05/2021 të datës 05.11.2021 të Komisionit Disiplinori Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, masa disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*", ndryshohet me masën disiplinore "*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për katër (4) vjet*".
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, dhe të kthejë ankuesin në vendin e punës, sipas Akt emërimit me numër 862/2012 të datës 13.04.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e tij e punës.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas Akt emërimit me numër 862/2012 të datës 13.04.2012 në pozitën "Drejtor i Departamentit të Prokurimit", më datë 07.10.2021 Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit parashtron kërkesë me numër të referencës 3647/2021 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj [redacted] tek Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 05.11.2021 nxjerr Vendim me numër KD NR.05/2021 me të cilin vendim ankuesit [redacted] i shqipton masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me Vendimin me numër KD Nr.05/2021 të datës 05.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 12.11.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 5418/21 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokat [redacted]

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 12.11.2021 nxjerr Vendimin me numër A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022 me të cilin vendim e shfuqizon vendimin e Komisionit Disiplinor me numër 05/2021 të datës 05.11.2021 dhe e kthen lëndën në rishqyrtim në Komision Disiplinor.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit pas pranimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 08.02.2022 e ka njoftuar Këshillin për zbatim të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022 me ç'rast organi i punësimit ka bashkangjitur Vendimin me numër 26/2022 të datës 28.01.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor si dhe Vendimin me numër 01/2022 të datës 31.01.2022 që përsëri është pezulluar ankuesi [redacted] deri në përfundimin e procedurës disiplinore.

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me Vendimin me numër 01/2022 të datës 31.01.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 09.02.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 625/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nëpërmjet përfaqësuesit të tij Avokat [redacted]

Ankuesi [redacted] me datë 14.03.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1343/2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor kundër heshtjes administrative të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mos zbatim të Vendimit A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me datë 23.03.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës merr vendimin me numër 16/2022 me të cilin vendim ankesa e ankuesit bashkohet me ankesën me numër A.nr.102/2022 të datës 09.02.2022 pasi që subjekti i ankesës është i njëjtë dhe bazohet në të njëjta fakte dhe bazë ligjore, ndërsa Kryetari i Këshillit pas kërkesës së Kryetares së Kolegjit për shqyrtimin e ankesave për zgjatjen e afatit të ankesës së ankuesit nxjerr vendimin me numër VK.30/2022 të datës 27.04.2022 që bëhet vazhdimi i afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Ankuesi me datë 30.03.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1694/2022 me pretendim ankimor kundër konkursit me numër 339/2022 për ngritje (Avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Prokurimit" i datës 02.02.2022 të Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Pas kërkesës së Kryetares së Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për bashkim të lëndës së ankuesit me numër A.nr.232/2022 të datës 14.03.2022, Kryetari i Këshillit me datë 05.05.2022 nxjerr vendim për bashkim të lëndëve të ankuesit me numër 22/2022.

Me datë 16.05.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendim me numër A.nr.313/2022 me të cilin e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit, si dhe e kishte anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Prokurimit", ndërsa e kishte obliguar Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të shqyrtojë lëndën e ankuesit ndërlidhur me shqiptimin e masës disiplinore. Mirëpo Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së, përmes shkresës së datës 07.06.2022 e kishte njoftuar Këshillin se me rastin e vendosjes ndërlidhur me ankesën e ankuesit të evidentuar nën shifrën A.nr.313/2022, ky i fundit nuk e kishte trajtuar vendimin e Komisionit Disiplinor të MKRS-së të datës 16.03.2022 sipas të cilit vendim, procedura disiplinore e iniciuar ndaj ankuesit është pezulluar, ndërsa ankuesi me datë 17.06.2022 nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtimin e ankesës nën shifrën A.nr.313/2022 pasi që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk e ka zbatuar të njëjtin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 12.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 11.11.2021 për Avokatin Akt emërimi i datës 13.04.2012; Vendimi i datës 05.11.2021 i Komisionit Disiplinor; e-mail-at e datave 17.06.2021, 10.06.2021, 09.06.2021, 08.06.2021, 28.05.2021, 27.05.2021; Kërkesa e datës 12.04.2021 për iniciimin e procedurës për vendosjen e fotos së Presidentit Republikës së Kosovës në MKRS-së; e-mail-at e datave 25.03.2021, 24.03.2021; Raporti i pranimit teknikë të përkohshëm me numër të referencës 4342/2020 i datës 08.12.2020; Raporti i komisionit të pranimit teknikë të punimeve të kontratës Intervenim Emergjent në Kullën datës 11.12.2020 me numër 4395/2020; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2020; Letër Konfirmimi i datës 12.07.2021 me numër 2349/2021-2; Buxheti i Kosovës për vitin 2020, 2019; e-mail-at e datave 12.03.2021, 19.01.2021, 25.12.2020, 30.09.2021, 12.04.2021; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës me numër 26.03.2013 me numër 1033/2013, Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm të MKRS-së i datës 23.06.2010 me numër 1329/2010; Vendimi i datës 27.08.2021 për formimin e Komisionit Disiplinor; Kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore e datës 07.10.2021 me numër 3647/2021; E-mail-at e datave 07.10.2021, 07.10.2021; Njoftimi për iniciim të procedurës disiplinore i datës 07.10.2021 me numër 3655/2021; Procesverbali

i Komisionit Disiplinor i datave 26.10.2021, 19.10.2021, 07.10.2021, 05.11.2021, 04.11.2021, 02.11.2021, 02.11.2021, 01.11.2021, 01.11.2021, 01.11.2021, 29.10.2021, 28.10.2021, 27.10.2021; E-mail i datës 05.11.2021; Opinioni i datës 02.11.2021 me numër të referencës 4133/2021 sipas kërkesës të datës 26.10.2021; Vendimi i datës 29.07.2019 me numër 3235/2019; Vendimi i datës 30.05.2019 me numër 2168/2019, E-mail-at e datave 09.07.2019, 08.07.2019; Vendimi i datës 05.09.2019 05Nr.350/02; Vendimi i datës 06.10.2017 me numër 87/2017; Raporti I për fillimin e punimeve "Hidroizolimi i kulmit të rrafshët dhe atikës në objektin e BKK-Pjetër Bogdani", me numër identifikues 207-19-2184-5-2-1 (207-19-017-5-2-1); Kërkesa e datës 20.08.2019 me numër 3552/2019; Deklarata nën betim e datës 10.06.2019; Vendimi i datës 30.11.2020 me numër 1218/2020; E-mail-it e datave 27.11.2020, 16.11.2020, 09.11.2020, 12.10.2020; Procesverbali i hapjes së tenderit me numër të prokurimit 207-19-7915-5-2-5; Njoftimi për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik i datës 18.10.2019 me numër 44271/2019; Deklarata e Nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve e datës 18.10.2019 me numër 4427/2019-2; Kërkesa e datës 20.08.2019 me numër 3552/2019; Kërkesa e datës 20.08.2019 me numër 3541/2019; Kërkesa për rialokim të projekteve kapitale e datës 24.04.2019 me numër 582-1; Kërkesa për rialokim të projekteve kapitale e datës 19.04.2019; Kërkesa e datës 15.06.2019 për ridestinim të mjeteve; Kërkesa për transfer/të dhënat e transferit rialokimit i datës 15.04.2019; Formulari për kërkesë i datës 12.03.2019 i Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani", Vendim i datës 12.10.2017 me numër 555; Kërkesa për rialokim të projekteve kapitale e datës 24.04.2019; Kërkesa për ridestinim të mjeteve e datës 16.04.2019; Ankesë kontrata e datës 28.09.2020; Njoftimi i datës 22.09.2010 për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik; Kërkesa për inicim të procedurës së prokurimit për projektin Rinovim i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës e datës 06.07.2020; E-mail i datës 11.06.2020; Raporti i vlerësimit të tenderit i datës 10.06.2019; Kontrata me numër të identifikues 207-19-2184-5-2-1 (207-19-017-5-2-1); Formulari për dorëzimin e tenderit me numër të prokurimit 207-19-2184-5-2-1; Njoftimi për nënshkrim të kontratës e datës 10.07.2019; Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit; Dosje e tenderit/procedurë e hapur e datës 24.10.2019; Raporti i vlerësimit të tenderit e datës 29.10.2019; Raporti i përfundimtar i punimeve-Intervenimi Emergjent në Kullën me referencë 03/2019; Dosja e Tenderit/procedura e hapur data 06.05.2020; Njoftimi për dhënien e kontratës datë 29.10.2019; Raport-mbikëqyrja e punimeve me referencë 01/2019; Kërkesa për pagesë të Situacionit të tretë me numër të referencës 07/2020; E-mail i datës 29.11.2019; Raporti i përfundimtar i punimeve-Intervenimi Emergjent në Kullën me referencë 05/2020; Raporti përfundimtarë i punimeve më numër të referencës 05/2020; Njoftim për dhënin e kontratës datë 15.05.2020; Njoftim për komisionin rregullativ të prokurimit publik i datës 04.05.2020; Raport me numër të referencës 01/2019 i datës 29.11.2019; Raport me numër të referencës 02/2019 i datës 29.11.2019; Njoftim për nënshkrimin e kontratës datë 22.05.2020; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 15.05.2020; E-mail i datës 07.07.2020; Përgjigje në kërkesë me numër të referencës 2021 i datës 08.04.2021; Vendim me numër 1273/2020 i datës 07.12.2020; E-mail i datave 07.12.2020, 05.12.2020; Raporti përfundimtar i punimeve më referencë 06/2020 i datës 23.11.2020; Kërkesa për pagesën e Stacionit të tretë me numër 07/2020 i datës 23.11.2020; Raportet e komisionit për praninë teknike të punimeve me referencë 12/2020 i datës 11.12.2020; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 29.10.2020; Kërkesë zotimi i datës 28.10.2020; Formulari për kërkesë i datës 07.10.2020; Kërkesë për zotime blerje e datës 26.03.2020; Formulari për kërkesë i datës 25.03.2020; Kërkesa për vazhdim të punimeve me referencë 71/2020 e datës 08.07.2020; Njoftimi për komisionin rregullativ të prokurimit publik i datës 04.05.2020; Raport për mbikëqyrjen e punimeve me referencë 02/2019 e datës 29.11.2019; Kërkesë për inicim të procedurave të

tenderimit e datës 19.09.2019 me numër 4003/2019; Rekomandimi i datës 16.08.2019 me referencë 360; Kërkesa për inicim të procedurave me referencë 85/2019 i datës 15.07.2019; Vendim me numër 1926/2019 i datës 15.10.2019; Vendimi me numër 1926/2019 i datës 15.10.2019; e-mail i datave 15.10.2019; 14.10.2019; Vendimi me numër 413/2020 i datës 15.05.2020; Kontrata me numër identifikues 207-19-7070-5-2-1 (207-19-084-5-2-1); Njoftim për nënshkrimin e kontratës datë 14.11.2019; Njoftim për dhënin e kontratës datë 07.11.2019; Njoftim për kontratë datë 23.09.2019; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 23.10.2019; Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 29.10.2019; Dosje tenderi/procedurë e hapur datë 20.09.2019; Njoftim për kontratë datë 22.08.2019; Njoftim për dhënin e kontratës datë 11.10.2019; Njoftim për nënshkrimin e kontratës datë 16.10.2019; Kërkesë për paradhënien e avancit për Projektin

Pejë e datës 24.10.2019 me numër 4504/2019; Kontrata me numër identifikues të kontratës 207-19-6177-5-2-1 (2019-19-072-5-2-1); Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues me numër të prokurimit 207-19-6177-5-2-1; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 26.09.2019; Kërkesë për pagesë të stacionit të fundit për projektin Ndërtimi i Kullës së me referencë 10/2020; Kërkesa për pagesë të situacionit përfundimtar për projektin Ndërtimi i murit mbrojtës në anën veri-lindore, me referencë 12/2020; Kërkesë për ndërtimin e murit mbrojtës më negocim në me referencë 09/2020; Vendim me numër 1646/2019 i datës 12.09.2019; E-mail i data 12.09.2019; Vendimi me numër 1954/2019 i datës 22.10.2019; Kërkesa për inicim të procedurës së prokurimit me numër 3415/2019 i datës 09.08.2019; Kërkesë për paradhënien e avancit për projektin me numër 4504/2019 i datës 24.10.2019; Vendimi me numër 1954/2019 i datës 22.10.2019; E-mail i datave 22.10.2019, 16.10.2019; Raporti i Mbikëqyrja e punimeve me referencë 08/2020 i datës 22.07.2020; Kërkesa për pagesë të punëve shtesë me referencë 09/2020 i datës 08.10.2020; Raporti i mbikëqyrjeve të punimeve referencë 01/2019 i datës 20.11.2019; Përgjigja në kërkesë me numër 1077/2021 e datës 08.04.2021; Vendimi me numër 1954/2019 i datës 22.10.2019; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 03.09.2020; Kërkesa për zotime blerje e datës 03.09.2020; Formulari për kërkesë e datës 02.09.2020; Raport mbikëqyrja e punimeve/punë shtesë me referencë 08/2020; Raport/punë përfundimtare ndërtimi i murit mbrojtës në anën veri-lindore

Lajçit me referencë 11/2020; Raport/punë përfundimtare me referencë 09/2020; Raporti mbikëqyrja e punimeve me referencë 07/2020 i datës 22.07.2020; Raport Mbikëqyrja e punimeve punë shtesë me referencë 08/2020 i datës 22.07.2020; Raporti mbikëqyrja e punimeve kërkesë për pagesë të Situacionit të dytë me referencë 06/2020; Raporti mbikëqyrja e punimeve ri fillimi i punimeve për ndërtimin e ne referencë 05/2020; Raport mbikëqyrje e punimeve kërkesa për ekzekutim të situacionit të I-rë me referencë 04/2019; Raport mbikëqyrja e punimeve referencë 03/2019; Raport mbikëqyrja e punimeve referencë 02/2019; Raport mbikëqyrja e punimeve me referencë 01/2019; Vendimi me numër 949/2021 i datës 15.09.2021; Vendim me numër 950/2021 i datës 15.09.2021; Amandamenti i kontratës me numër të kontratës 207-19-6177-5-2-1 (207-19-072-5-2-1); Kërkesa për paradhënie e avancimit për Projektin me numër 4504/2019 e datës 24.10.2019; Kontrata me numër të identifikimit 207-19-6177-5-2-1; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 14.10.2020; Vendimi me numër 1322/2020 i datës 09.12.2020; e-mail i datës 08.10.2020; Raport i vlerësimit të tenderëve datë 18.12.2020; Njoftimi mbi vendimin e autoriteteve kontraktuese datë 28.12.2020; Kontrata me numër identifikues 207-20-8109-5-3-6; Raporti mbi kthim dorëzimin e pajisjeve të IT-së datë 19.08.2021; Raporti i pranimit

teknik i datës 09.06.2021; Vendimi me numër 520/2021 i datës 27.05.2021; Furnizim me pajisje të teknologjisë informative e datës 18.08.2021 me numër 2821/2021; e-mail i datave 23.11.2020, 20.11.2020; Vendimi me numër 1174/2020 i datës 23.11.2020; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 01.12.2020; Njoftim për dhënie të kontratës datë 16.12.2020; Raporti i pranimit teknik i datës 09.06.2021 me numër 1909/2021; Kërkesa e datës 07.09.2021 me numër 3043/2021; Kontratë me numër identifikues 207-20-4410-1-2-1 (207-20-079-1-2-1); Vendimi me numër 694/2021 i datës 13.07.2021; Njoftim mbi kryerjen e punimeve i datës 14.12.2020; Njoftimi mbi punimet shitesë me numër 139; Raporti përmbledhës i punimeve me numër 2375/2021 i datës 13.07.2021; e-mail i datave 02.07.2021, 01.07.2021, 30.06.2021, 29.06.2021, 18.06.2020, 16.06.2020; Raporti nga inspektimi i Kullës së Sheremetit i datës 03.07.2021; Raporti i punimeve me referencë 87/2020; e-mail i datës 12.08.2021; Njoftim për shkëputje të kontratës me numër 2741/2021 i datës 12.08.2021; e-mail i datës 06.08.2021; Rekomandim për projekt kapitalë me numër 2662/2021 i datës 05.08.2021; Kërkesa për shkëputje të kontratës me numër 1399/2021 i datës 07.05.2021; Njoftim mbi kryerjen e punimeve numër 138; Njoftim me referencë 64-2021; Vendimi me numër 1001/2020 i datës 16.10.2020; e-mail i datave 16.10.2020, 29.10.2019, 06.10.2020; Njoftim mbi gjendjen e me referencë 29-2021; Njoftim mbi gjendjen e Kullës me referencë 34-2021; Njoftim mbi gjendjen e Kullës me referencë 24-2021; e-mail i datave 08.10.2020, 07.10.2020, 06.10.2020, 18.12.2020, 21.10.2020, 07.12.2020; Kontrata me numër identifikues 207-19-8203-5-2-1 (207-19-094-5-2-1); Formulari për dorëzimin e tenderit me numër të prokurimit 207-19-8203-5-2-1; e-mail i datës 04.08.2021; Raporti i inspektimi në monumentet e trashëgimisë kulturore me numër 2505/2021 i datës 23.07.2021; Raport inspektimi datë 23.07.2021; Njoftim për shkëputje të kontratës me numër 2741/2021 i datës 12.08.2021; Rekomandimi për projektet kapitale me numër 2662/2021 e datës 05.08.2021; Kontratë me numër 209-19-3048-5-2-1 (207-19-033-5-2-1); Kontrata me numër identifikues 207-19-1888-5-2-1 (207-19-016-5-2-1); Kontratë me numër identifikues 207-19-5989-5-2-1 (207-19-070-5-2-1); Kërkesa e datës 16.04.2021; Fletëpranimit i mallrave; Kërkesë për iniciimi procedure për vendosjen e fotos së Presidentit të Republikës së Kosovës e datës 12.04.2021; e-mail i datës 02.11.2021; Urdhër pagesa e datës 19.10.2020; Formulari i Certifikimit të Dokumentacionit i datës 19.10.2020; Raporti i pranimit i datës 29.09.2020; Urdhër blerje e datës 28.09.2020; Kërkesë zotim për blerje e datës 24.09.2020; Kërkesë për mallra dhe shërbime e datës 24.09.2020; e-mail i datave 19.10.2020, 12.10.2020; Urdhër pagesa e datës 19.10.2020; Formulari certifikimi i dokumentacionit i datës 19.10.2020; Raporti i pranimit i datës 29.09.2020; Urdhër blerje e datës 28.09.2020; Kërkesë për zotim për blerje e datës 15.09.2020; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 15.09.2020; e-mail i datës 19.10.2020, 12.10.2020, 02.11.2021, 01.12.2021, 29.10.2021; Urdhër pagesa e datës 19.10.2020; Raporti i pranimit i datës 29.09.2020; Urdhër blerje 28.09.2020; Kërkesë për zotim për blerje e datës 24.09.2020; Kërkesë për mallra dhe shërbime e datës 24.09.2020; Kontrata me numër identifikues 207-19-8203-5-2-1 (207-19-094-5-2-1); Formular për dorëzimin e tenderëve me numër identifikues 207-19-8203-5-2-1; Raporti me numër 5055/2019 i datës 29.11.2019; Raport me numër 5054/2019 i datës 29.11.2019; Vendimi me numër 1999/2019 i datës 30.10.2019; Vendimi me numër 1997/2019 e datës 30.10.2019; Kontrata me numër identifikues 207-19-7070-5-2-1 (207-19-084-5-2-1); Urdhër obligimi pagesë i datës 12.04.2019; Raporti i pranimit i datës 08.04.2019; Urdhër blerja e datës 08.04.2019; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 08.04.2019; Kërkesë për zotim për blerje e datës 08.04.2019; Formulari për kërkesë e datës 08.04.2019; Urdhër pagesë e datës 06.12.2019; Raporti i pranimit 04.12.2019; Urdhër blerje e datës 05.12.2019; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 22.07.2019; Kërkesë për zotim për blerje e datës 22.07.2019; Formular për kërkesë datë 15.07.2019; Raport mbikëqyrje e

punimeve me numër 5059/2019 e datës 04.12.2019; Formulari për dorëzimin e tenderit me numër 207-19-6177-5-2-1; Urdhër blerja e datës 31.10.2019; Kërkesa për mallra dhe shërbime e datës 31.10.2019; Kërkesë për zotim për blerje e datës 31.10.2019; Formular për kërkesë e datës 28.10.2019; Kontrata me numër 207-19-6177-5-2-1 (207-19-072-5-2-1); E-mail i datave 12.08.2021, 05.08.2021, 19.08.2021, 06.11.2020, 25.12.2020, 18.11.2020, 25.10.2021; Kërkesë për sqarim me numër 3073/2021 i datës 08.09.2021; e-mail i datës 26.10.2021; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe Vendimi VK.Nr.66/2021 i datës 24.12.2021 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për zgjatjen e afatit të lëndës së ankuesit Vendimi A.Nr.928/2021 i datës 10.01.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi për zbatim të vendimit nga organi i punësimit i datës 08.02.2022; Vendimi i datës 28.01.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 28.01.2022; Vendimi i datës 31.01.2022 me numër 01/2022 i Komisionit Disiplinor; Ankesa e ankuesit e datës 09.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i ankuesit i datës 25.02.2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 14.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi për bashkim të lëndëve i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër 16/2022 i datës 23.03.2022; Vendimi për zgjatje të afatit për vendimmarrje me numër 30/2022 i datës 27.04.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 30.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi për bashkim të lëndëve Nr.22/2022 i datës 05.05.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil të Kosovës; Konkursi i datës 02.02.2022 me numër 339/2022; Njoftimi i datës 28.03.2022 për kandidatin e suksesshëm; Parashtresa njoftuese e ankuesit 01.03.2022 për organin e punësimit; Përgjigja në parashtresën nga organi i punësimit i datës 21.03.2022; Njoftimin e datës 07.09.2022 të Zëvendës Sekretarit të MKRS-së; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 16.03.2022 me numër Nr.03/2022; Njoftimin e datës 30.03.2022 të Zëvendës Sekretarit të MKRS-së; E-mailin e datës 30.05.2022 dërguar nga Sh.I për V.K; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 28.02.2022 me numër Nr.02/2022; Vendimin e Këshillit me numër A.nr.313/2022 të datës 16.05.2022; Kërkesën e ankuesit të datës 17.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, **SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ndaj ankuesit i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas Akt emërimit të datës 13.04.2012 në pozitën "Drejtor i Departamentit të Prokurimit", më datë 07.10.2021 Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit parashtron kërkesë me numër të referencës 3647/2021 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj me detyrë Udhëheqës i Divizionit për Prokurim Publik në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komisioni Disiplinor me datë 05.11.2021 nxjerr Vendim me numër KD Nr.05/2021 me të cilin vendim ankuesit i shqipton masën disiplinore „Largimi nga Shërbimi Civil i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit”. Pas shqyrtimit të ankesës së datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesi Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.01.2022, nxjerr Vendim me numër A.nr.928/2021 me të cilin e shfuqizon vendimin e Komisionit

Disiplinor me numër 05/2021 të datës 05.11.2021 dhe e kthen lëndën në rishqyrtim në Komision Disiplinor respektivisht e kishte obliguar Komisionin Disiplinor të rishqyrtoj dhe vlerësoj rastin me të gjitha provat e bashkangjitura dhe të nxjerr vendim meritor për nëpunësin civil

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit pas pranimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 28.01.2022 nxjerr Vendim me numër 26/2022 me të cilin themelon Komisionin Disiplinor, ndërsa me datë 31.01.2022 Komisioni Disiplinor i MKRS nxjerr Vendim me numër 01/2022 me të cilin pezullohet nga detyra "Drejtor i Departamentit të Prokurimit", si masë e sigurisë për zhvillimin e hetimit disiplinor të papenguar deri në përfundimin e procedurës disiplinore të iniciuar me shkresën me numër të protokollit 267/2022 të datës 28.01.2022. Pastaj me datë 28.02.2022, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nxjerr vendimin me numër 02/2022 me të cilin e ka shtyrë afatin për përfundimin e procedurës disiplinore ndaj edhe për tridhjetë (30) ditë deri me datë 28.03.2022.

Ankuesi i pakënaqur me heshtjen administrative të Komisionit Disiplinor respektivisht me moszbatimin e Vendimit me numër A.Nr.928/2021 të datës 10.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.03.2022 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor kundër heshtjes administrative të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe kërkon nga Këshilli që të vendos meritorisht lidhur me rastin e po ashtu e kundërshton edhe Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 31.01.2022 me numër 01/2022 dhe Vendimin me numër 02/2022 të datës 28.02.2022. Këshilli me datë 16.05.2022 ka nxjerrë vendimin me numër A.nr.313/2022 përmes të cilit e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit, si dhe e kishte anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Prokurimit", ndërsa e kishte obliguar Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të shqyrtojë lëndën e ankuesit ndërlidhur me shqiptimin e masës disiplinore. Mirëpo Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së, përmes shkresës së datës 07.06.2022 e kishte njoftuar Këshillin se me rastin e vendosjes ndërlidhur me ankesat e ankuesit të evidentuara nën shifrën A.nr.313/2022, ky i fundit nuk e kishte trajtuar vendimin e Komisionit Disiplinor të MKRS-së të datës 16.03.2022 sipas të cilit vendim, procedura disiplinore e iniciuar ndaj ankuesit është pezulluar, ndërsa ankuesi me datë 17.06.2022 nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ka parashtuar kërkesë për ri-shqyrtimin e ankesës nën shifrën A.nr.313/2022 pasi që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk e ka zbatuar të njëjtin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, me arsyetimin se Komisioni Disiplinor me rastin e moszbatimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerrjes se masës pezulluese ndaj ankuesit dhe shtyrjes se afatit të procedurës disiplinore ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të ligjit material.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës, pretendimeve të ankuesit të paraqitura pranë Këshillit përmes kërkesës së datës 17.06.2022 dhe Vendimit me numër:1039/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i datës 16.03.2022 ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, respektivisht Zëvendës Sekretari i

Përgjithshëm si dhe Komisioni Disiplinor nuk kanë arritur në plotëni të zbatojnë Vendimin me numër A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022 dhe Vendimin me numër A.nr.313/2022 të datës 16.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas inicimit të procedurës disiplinore sipas kërkesës së ministrit, ku ndaj ankuesit Komisioni Disiplinor i kishte shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" përmes Vendimit të datës 05.11.2021, vendim të cilin Këshilli e kishte shfuqizuar përmes Vendimit me numër A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022, ndërsa sërish Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.313/2022 të datës 16.05.2022 kishte kërkuar shqyrtimin e procedurës disiplinore të ankuesit sipas kërkesës së datës 28.01.2022 me numër 267/2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, pasi që procedura disiplinore ndaj ankuesit është pezulluar, ndërsa ankuesi mbetet i pezulluar deri në përfundimin e procedurës me arsyetimin se ndaj të njëjtit Policia e Kosovës përmes shkresës së datës 09.03.2022 e kishte njoftuar se lidhur me Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2020 janë duke u zhvilluar hetime lidhur me nënshkrimin e tri aneks kontratave ku është tejkaluar 10% i vlerës së kontratës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin me numër:1039/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të datës 16.03.2022 përmes të cilit procedura disiplinore është pezulluar, gjegjësisht ka analizuar bazën ligjore në të cilën është referuar Komisioni Disiplinor dhe ka ardhur në përfundim se neni 85 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështje paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*, është i paqëndrueshëm në rastin konkret, ngase sipas arsyetimit të dhënë nga vetë Komisioni Disiplinor, Kolegji i Këshillit vlerëson që policia në rastin konkret nuk është organ vendimmarrës dhe nuk mundet të konstatojë nëse ankuesi është përgjegjës apo jo, ngase këtë autoritet apo autorizim ligjor e kanë gjykatat respektive dhe se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të dëshmojë nëse ndaj ankuesit gjykata ka konfirmuar ndonjë aktakuzë, apo veprim ose vendim tjetër procedural lidhur me rastin, rrjedhimisht me rastin e mos shqyrtimit të rastit të ankuesit Komisioni Disiplinor ka dal jashtë mandatit dhe autorizimeve ligjore të paracaktuara me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura" dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore"*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe nenin 48 paragrafin 5 si dhe nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar; Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; 1.9. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj"* dhe ka ardhur në përfundim se Komisioni Disiplinor në arsyetimin e dhënë në vendimin e tij të datës

16.03.2022 është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim të plotë me bazën e përdorur ligjore respektivisht neni 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili parasheh që Komisioni Disiplinor mund ta pezullojë ankuesin përkohësisht mirëpo vetëm nën mandatin dhe autorizimin ligjor respektivisht vetëm deri në momentin e përcaktuar sipas afatit ligjor me rastin e nxjerrjes së vendimit për shqyrtimin e rastit të inicuar disiplinor apo vendosjes meritorë, ndërsa kuptimi i nenit 85 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i jep të drejtë institucionit të pezullojë çështjen kryesore në rastin konkret shqyrtimin dhe vendosjen për iniciimin e procedurës disiplinore, por jo edhe pezullimin e ankuesit pambarimisht, ngase Komisioni Disiplinor ka kompetencë të pezullojë nëpunësin ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedurë disiplinore vetëm për aq kohë sa zgjatë procedura e vendimmarrjes respektivisht vetëm tridhjetë (30) ditë, ndërsa të drejtën e shqiptimit të masës parandaluese „mos ushtrimin e detyrës” Ligji për Zyrtarët Publik ia ka besuar apo e ka autorizuar vetëm një institucion dhe se pezullimi apo jo i nëpunësit civil ndaj të cilit është hapur proces gjyqësor është në diskrecion të gjykatës siç përcaktohet në mënyrë specifike me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet: *Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi*, andaj në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1; 1.2; 1.3; 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”* Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2022 lidhur me pezullimin e shqyrtimit të iniciimit të procedurës disiplinore në të njëjtën kohë edhe pezullimi i ankuesit është vendim i paligjshëm pasi që një veprim i tillë është jashtë diskrecionit dhe autorizimeve ligjore të komisionit disiplinor, përderisa e njëjta kompetencë me ligjin material i është besuar një institucioni tjetër, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së masës pezulluese ndaj ankuesit dhe shtyrjes së afatit të procedurës disiplinore referuar vendimit të datës 16.03.2022 ka bërë shkelje të dispozitave procedurale është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se me rastin e paraqitjes së shkeljeve të supozuara të detyrës zyrtare dhe rekomandimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 07.10.2021 me numër të protokollit 3647/2021 e cila paraqitje është ri konfirmuar edhe me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me datë 28.01.2022 me numër të protokollit 267/2022, është inicuar rast për procedim në Komision Disiplinor për shkeljet e supozuara të kryera nga ankuesi që nga viti 2019, 2020 dhe 2021. Andaj me rastin e iniciimit të procedurës disiplinore nuk është marr parasysh fakti se me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa me datë 25.11.2019, Gjykata Kushtetuese me Vendim Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme e ka pezulluar Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Gjykata Kushtetuese të gjitha institucionet publike kanë aplikuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil deri më datë 09.07.2020 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Si rrjedhojë edhe për herë të dytë iniciimi i procedurës disiplinore

respektivisht kërkesa për ri-shqyrtim të lëndës së ankuesit duke iu referuar kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së të datës 28.01.2022 ndaj ankuesit është iniciuar duke bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale sepse për shkeljet e supozuara disiplinore të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore kur ka qenë në fuqi gjegjësisht i aplikueshëm Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, madje nuk e kanë pas parasysh faktin se edhe me Vendimin me numër A.nr.928/2021 të datës 10.01.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë evidentuar këto shkelje dhe se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e rishqyrtimit të lëndës ka pas për obligim që t'i ketë parasysh se për cilën periudhë kohore është iniciuar rasti dhe të marr vendim meritor, mirëpo Komisioni Disiplinor nuk e ka rishqyrtuar rastin sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji thekson faktin se Ligji Nr.06/L-114-për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2022 sipas Aktgjykimit Nr. ref.:AGJ 1583/20 të Gjykatës Kushtetuese përmes të cilit ka vendosur për rastin e ngritur nga Avokati i Popullit nr. KO203/19, në dispozitat transitorë të tij, respektivisht nenin 83 paragrafi 9 përcakton se: *".....Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me kërkesën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjta procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve"* me çka nënkuptohet se sipas fuqisë së ligjit dispozitat e tij nuk kanë efekt prapaveprues mirëpo e ka rregulluar vetëm natyrën e procedurës disiplinore në proces e sipër, madje ia ka lënë në diskrecion palës të vendos nëse janë më të favorshme me qëllim që procedura disiplinore të vazhdoj sipas dispozitave të ligjit të ri, andaj Kolegji i Këshillit vlerëson se ndaj asnjë nëpunësi civil institucioni punëdhënës në rastin konkret Komisioni Disiplinor nuk mund të trajtoj shkeljet e pretenduara dhe as të shqiptojë masa disiplinore mbi bazën e Ligjit Nr.06/L-114-për Zyrtarët Publik për kohën sa në fuqi kanë qenë dispozita tjera të ligjit material, ndërsa të drejtën për hetuar dhe gjykuar rastet e keqpërdorimit të detyrës dhe autoritet zyrtar e ruajnë institucione tjera vendimmarrëse në zbatim të legjislacionit përkatës të aplikuar në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, Kolegji ka gjetur se institucioni punëdhënës respektivisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk e ka respektuar nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën"*, pasi që ankuesi pavarësisht që ka parashtruar ankesë në Këshill, ndaj të njëjtit aktet e konstatuara që nga rasti fillestar me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"* përmes vendimit të datës 05.11.2021 e deri tek vendimi i fundit i Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2022 i cili vazhdon ta mbaj ankuesin jashtë procesit të punës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj, përderisa sipas nenit 2 paragrafi 1 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: *"Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ"*, rrjedh se institucioni punëdhënës është dashur të veprojë sipas detyrës zyrtare ndërsa me akte të veçanta është dashur të bëjë pezullim e prodhimit të pasojave përderisa të njëjtat kanë rrjedhur për një periudhë të gjatë mujore, shtuar faktin kësaj, shmangies apo mos gatishmërisë që për rastin në fjalë të veprojë sipas kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore që ka pasur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shkak të ikjes nga përgjegjësia apo mos ri-shqyrtimit të procedurës disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor, ka shqyrtuar rastin e ankuesit meritorisht për aq sa provat relevante kanë qenë të evidentueshme dhe ka ardhur në përfundimin se me rastin e gjetjeve në Raportin e Auditimit për Pasqyrat, Financiare, Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Vitin 2020 dhe ka vlerësuar se me rastin e nënshkrimit të dy aneksë kontratave për "Hidroizolimi i kulmit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës", dhe "Ndërtimi i kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kushtet në teren, andaj duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 pika (iii) ku është përcaktuar se: "nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivoisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues" dhe sipas Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik ka përcaktuar se: "13.10 Një kontratë nuk mund të vazhdohet, të përtërihet ose të përcjellët nga një kontratë pasuese pa administrimin e procedurës së re. Megjithatë, brenda një shume prej 10% të vlerës së kontratës një kontratë për furnizime/shërbime/punë shtesë, të cilat nuk ishin përfshirë, dhe as kryer në kontratën origjinale, por të cilat për arsye të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës, mund të ofrohet për OE përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kur një kontratë e tillë shtesë është relativisht e parashikueshme, vlera e tillë duhet të përfshihet në vlerën origjinale të parashikuar të kontratës", andaj Kolegji i Këshillit vlerëson se në rastin konkret ankuesi referuar të gjeturave si më lartë është përgjegjës për rastin e nënshkrimit të aneks kontratave duke tejkaluar 10% të vlerës së kontratës të cilat tejkalime ishin te kontrata "Hidroizolimi i kulmit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës", dhe "Ndërtimi i dhe si rrjedhojë i njëjti në rastin konkrete ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës për shkak të moszbatimit të dispozitave ligjore të evidentuara si më lartë për përmbushjen e detyrave funksionale në cilësi të Drejtorit të Departamentit të Prokurimit, prandaj pretendimi ankimor i ankuesit se i njëjti nuk është përgjegjës për shkeljet e pretenduara është i pabazuar, mirëpo Kolegji po ashtu ka pasur parasysh si rrethanë lehtësuese të gjeturën e auditimit në Raportin e Auditimit për Pasqyrat, Financiare, Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Vitin 2020, Çështja A2-shpenzimet shtese si pasojë e hartimit te dobët te projekteve dhe specifikimeve teknike ne faqe 13 ku citohet:" Mangësitë e përmendura me lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kushtet në teren, si dhe nga futja e projekteve në ligj të buxhetit pa ndonjë analize paraprake të mirëfilltë të projekteve".

Andaj, meqenëse Këshilli i Kolegjit nga administrimi i provave ka gjetur se Komisioni Disiplinor pas shqiptimit të masës disiplinore përmes Vendimit me numër KD/Nr.05/2021 të datës 05.11.2021, vendim të cilin Këshilli e kishte shfuqizuar përmes vendimit A.nr.928/2021, më nuk ka arritur të ri-shqyrtojë lëndën e ankuesit me arsyetimin se lënda ka qenë voluminoze dhe ka pasur shumë prova, rrjedhimisht nuk ka arritur të vërtetoj përgjegjësinë e ankuesit lidhur me parregullsitë të specifikuara në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, madje Komisioni Disiplinor me rastin e mos shqyrtimit të rastit të ankuesit ka hequr dorë në mënyrë të kundërligjshme nga autorizimet dhe kompetencat ligjore që ia garanton dhe obligon ligji material, si dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi sipas shkresave të lëndës nuk ka masa tjera disiplinore

të mëparshme të pashlyera, Kolegji i Këshillit vlerëson se masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" e shqiptuar fillimisht nga ana e Komisionit Disiplinor përmes vendimit të datës 05.11.2021 është masa më e rëndë që mund t'i shqiptohet një nëpunësi civil dhe si e tillë nuk është në proporcion me shkeljet e gjetura dhe të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, siç përcaktohet edhe me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku për caktohet se: "Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sipas të gjeturave të pasqyruara si më lartë ka konstatuar se pavarësisht që Vendimi KD Nr.05/2021 i datës 05.11.2021 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ishte shfuqizuar përmes vendimit të Këshillit me numër A.nr.928/2021 i datës 10.01.2022, mirëpo i njëjti kishte vazhduar të prodhojë efekte juridike për palën ankuese, ngase ministria në fjalë respektivisht organet e obliguara për zbatimin e vendimit të Këshillit nuk kanë nxjerrë asnjë akt administrativ për ndaljen e prodhimit të pasojave juridike në dëm të palës, dhe mbi bazën e gjendjes faktike masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" ka qenë në fuqi në secilën fazë të trajtimit të ankesave të pasqyruara si në kronologjinë hyrëse të arsyetimit të këtij vendimi, ngase është konstatuar dhe pasqyruar si më lartë se Komisioni Disiplinor nuk ka pasur të drejtë dhe as autorizim ligjor që të mbajë ankuesin të pezulluar nga puna dhe njëkohësisht të refuzojë të trajtojë apo ri-shqyrtojë lëndën e tij.

Kështu që, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 46 paragrafi 1, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: "Kolegjet e Këshillit që shqyrtojnë ankesat, bazuar në paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të këtij neni, kanë të drejtë të ndryshojnë masën disiplinore në rastet kur vërtetohet se nëpunësi civil e ka kryer shkeljen, mirëpo organi i punësimit nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer", mbi bazën e të gjeturave të pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ka vendosur që ankuesit t'ia ndryshojë masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" të shqiptuar përmes Vendimit KD Nr.05/2021 të datës 05.11.2021 të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kështu që masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", ndryshohet me masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për katër (4) vjet".

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ka mandat ligjor që ta obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, respektivisht brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duhet ta kthejë ankuesin në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit sipas Akt emërimit me numër 862/2012 të datës 13.04.2012 me të gjitha të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: "Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës", ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: "Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.313/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.